



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NDËRMARRJA E PASTRIMIT DHE HIGJENES FIER**

Nr. ____/____Prot.

Fier, më .12.2025

Lënda: Formulari i njoftimit të fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit per proceduren: “Marrje mjeti Buldozer me qira”, për nevojat e Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Higjenës Fier, Bashkia Fier Për vitin 2026’, me burim financimi nga Ndërmarrja e Pastrimit dhe Higjenes Fier.

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)**

Shtojca 12

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE TË PASTRIMIT FIER

Data: 30.12.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik Q.SINAJ SHPK

Adresa: Fier ZHAREZ ZHAREZ Fshati Zharez. Rruga FierRoskovec. Godina ish. Pallati i kultures. Kati 1.

NUIS K82529403A

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

* * *

Tipi i Kontratës: **Shërbim**

Procedura e prokurimit: **E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike.**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-71302-12-05-2025**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Marrje mjeti Buldozer me qira”, për nevojat e Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Higjenës Fier, Bashkia Fier Për vitin 2026, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej 9 794 166.67 (nente milion e shtateqind e nentëdhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pike gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH dhe 11 753 000 (njemëdhjetë milion e shtateqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë me TVSH, me burim financimi nga Ndërmarrja e Pastrimit dhe Higjenës Fier.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: **365 dite nga nënshkrimi i Kontratës.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **09.12.2025 (d/m/v) Ora 10:00**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike [15 Dhjetor 2025], [Numri 79].

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- Operatori ekonomik **Vellezerit Agalliu 20 Sha, me NUIS M07214203A**. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 8 589 545 (tete milion e pesëqind e tetëdhjetë e nentemijë e pesëqind e dyzet e pese) leke pa TVSH.
- Operatori ekonomik **“Q.SINAJ” SHPK, me NUIS K82529403A**. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 8,868,000 (tete milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tete mijë) leke pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik **Vellezerit Agalliu 20 Sha, me NUIS M07214203A**. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 8 589 545 (tete milion e pesëqind e tetëdhjetë e nentemijë e pesëqind e dyzet e pese) leke pa TVSH.

O.E. **“VËLLEZËRIT AGALLIU 20 sh.a** “ skualifikohet pasi nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në DST dhe shtojcës përkatëse, sa i takon *“dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit”*, në kuptim të nenit 77 të LPP-së dhe pikës 5, të nenit 39, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, për arsyet si më poshtë argumentuar:

O.E. **“VËLLEZËRIT AGALLIU 20 sh.a”** për këtë procedurë prokurimi konstatohet se ka paraqitur në SPE gjithsej 2 (dy) kontrata/fatura shitje (përvoja) të mëparshme për shitje malli, të cilat nuk vlerësohen punë të ngjashme me objektin e prokurimit i cili sipas Dokumentave Standarde-Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Shërbime, është kryerja e shërbimit ***“Marrje mjeti Buldozer me qira”***, ***për nevojat e Ndërmarrjes së Pastrimit dhe Higjenës Fier, Bashkia Fier Për vitin 2026”***, sipas kushteve të shërbimit, termave të references të shërbimit dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, ndërkohë OE ofertues **VËLLEZËRIT AGALLIU 20 sh.a** ka paraqitur 2 (dy) kontrata/fatura shitje për shitje malli dhe jo për shërbimin e kërkuar sipas objektit të prokurimit, dhe në këto kushte këto kontrata/fatura shitje nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të kapacitetit teknik, për përvojat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, kryerje shërbimi.

Konkretisht, komponentët të cilët karakterizojnë kontratën objekt-prokurimi, kërkojnë eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga shoqëria **“VËLLEZËRIT AGALLIU 20 sh.a”** me anë të dokumentacionit të sipërcituar, referuar specifikimeve teknike, termave të referencës dhe komponentëve përbërës të shërbimit të marrjes me qira të mjetit buldozer, shërbim i përshkruar qartë në DST. KVO gjykon, se krahasueshmëria e eksperiencave të mëparshme nëse janë të ngjashme, nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës referuar një analize të përgjithshme dhe sipërfaqësore, nëse ajo është një kontratë për shërbime, por për më tepër si autoriteti kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave, edhe operatori ekonomik në momentin e hartimit të ofertës duhet të mbajë në konsideratë të gjithë komponentët që karakterizojnë kontratën, duke iu referuar qëllimit (ratio legis) të kërkesës për të zbatuar kontratën (shërbimit marrje me qira) sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. KVO konstaton, se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha elementeve të ofruar, duke nisur që nga objekti i kontratës së ofruar, rezulton, se këto kontrata/fatura shitje (përvoja) të mëparshme për shitje malli, nuk mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e prokurimit marrje me qira mjeti buldozer. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, KVO, gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik **“VËLLEZËRIT AGALLIU 20 sh.a”**, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor. Kjo është edhe një analizë ligjore dhe qëndrim i konsoliduar edhe i KPP gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të çështjeve në lidhje me eksperiencën e mëparshme të ngjashme (Vendimi 539/2023 datë 29.06.2023, etj.).

Në rastin konkret, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson, se kontrata me objekt: ***“Blerje rul ngjeshës deri në 5 ton , për vitin 2025”***, me nr.916/29 prot., date 25.11.2025 dhe fatura me nr. 223/2024, datë 02.03.2024 dhe dokumentacioni që e shoqëron këtë kontratë, të paraqitura nga operatori ekonomik **“VËLLEZËRIT AGALLIU 20 sh.a”** në procedurën e prokurimit, nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të kapacitetit teknik, për përvojat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

Për këtë arsye, bazuar në kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik në DST dhe shtojcës përkatëse, bazuar në nenin 77 të LPP-së dhe pikën 5, të nenit 39, të VKM nr.285, datë 19.5.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar autoriteti kontraktor gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik **“VËLLEZËRIT**

AGALLIU 20 sh.a” , për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, nuk është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, dhe për këtë arsye **s’kualifikohet.**

*** * ***

- Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“Q.SINAJ” SHPK, me NUIS K82529403A**, me adresë Fier ZHAREZ ZHAREZ Fshati Zharez. Rruga FierRoskovec. Godina ish. Pallati i kultures. Kati 1, se oferta e paraqitur me një vlerë totale prej 8,868,000 (tete milion e teteqind e gjashtedhjetë e tete mijë) leke pa TVSH., është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Emiliano SKËNDA